



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë-Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine-Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Njësia e Burimeve Njerëzore/ Jedinca Ljudski Resursa/ Human Resources Unit

Datë: 08.05.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në pajtim me nenin 7 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, publikon:

NJOFTIM
Për Anulimin e Konkursit

Anulimi i konkursit për pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me nr. RN00017436 bëhet për arsye se në verifikim paraprak ka kaluar vetëm një (1) kandidat.

Sipas legjislacionit aktual në fuqi, pranimi në pozitë të lartë drejtuese bëhet me konkurs të hapur dhe publike, konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza:

1. Verifikimi paraprak. përmes së cilit verifikohet nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit; dhe
2. Vlerësimi profesional, që përfshin vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Po ashtu sipas legjislacionit në fuqi në rast se procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidat/at fitues të vlerësuar mbi pragun minimal të shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet procedurë e re rekrutimi.

Në mungesë të konkurrencës prej dy kandidatëve procedura e rekrutimit ndërpritet dhe rrjedhimisht nuk janë krijuar kushte ligjore për të vazhduar rekrutimi në faza tjera.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

